

Hyrje në hapsirë të ngushtë

Zgjidhjet për punëtorët e ujërave të ndotura



Sepse çdo jetë ka një qëllim...



Zgjidhjet e MSA-së për ujin dhe ujërat e ndotura

Në industrinë e ujit dhe të ujërave të ndotura, operatorëve shpesh u kërkohet që të hyjnë nëpër hapsira të ngushta për të kryer pastrimin, servisimin, mirëmbajtjen dhe kontrollimet. Në industrinë e ujit ka hapsira të ngushta të ndryshme, si puseta, kanalizime, rezervuarë, stacione të pompave, tubacione, dhe kanale.

Hapsira e ngushtë mund të përkufizohet si një zonë që:

- Është mjaft e madhe për një punëtorë që të futet me tërë trupin dhe ta kryej punën.
- Ka mjete të kufizuara të nevojshme për hyrje dhe dalje.
- Nuk është e projektuar për qëndrim të gjatë të njerëzve.

Megjithatë, në këto zona, ekziston rreziku nga anoksia, asfiksioni, helmimi ose shpërthimi. Përveq kësaj ekzistojnë rreziqe të tjera, si rënie ose goditje elektrike.

Çdo vit njerëzit vdesin pas hyrjes nëpër këto hapsira, duke i nënvlerësuar rreziqet, dhe të tjerët gjithashtu e rrezikojnë jetën e tyre duke u munduar për ti shpëtuar ata.

Në Europë, qindra dhe mijëra punëtorë nga kompanitë private dhe autoritetet publike janë të përfshirë në operimin, servisimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të ujit dhe kanalizimeve, nëpër të cilat kalojnë miliona metra kub ujë çdo ditë.

A e keni ditur...?

Të dhënat e aksidenteve tregojnë se viktimat e aksidenteve në hapsira të ngushta janë të profesioneve të ndryshme. Përderisa shumica e tyre janë punonjës dhe kontraktorë, viktimat gjithashtu përfshijnë edhe stafin inxhinierik dhe teknik, mbikqyrësit dhe menaxherët, si dhe personelin për punë emergjente. Fatkeqësisht, tragjeditë njerëzore dhe shkalla e lartë e mortalitetit për incidentet që përfshijnë hapsira të ngushta është një çmim që shpesh paguhet dy herë: një herë nga ata që fillimisht hyjnë dhe përsëri nga ata që më pas përipiqen të shpëtojnë.

Sipas ILO dhe OSHA, aksidentet që ndodhin në hapsira të ngushta numërojnë rreth 200 viktima brenda vitit në mbarë botën. Rreth dy të tretat e aksidenteve në hapsira të ngushta shkaktohen nga kushtet e rrezikshme atmosferike. Në 70% të këtyre rasteve, rreziku ekziston para hyrjes dhe fillimit të punës.

Source: Health and Safety International

ILO: International Labour Office; OSHA: Occupational Safety and Health Administration

Zgjidhjet për hyrje në hapsira të ngushta

Pikat e Vetme Të ankorimit

Tripod MSA Workman

Tripodi i aluminit është një pikë ideale ankorimi për detyra me staf të limituar, që peshon vetëm 19.5 kg me gjatësi maksimale prej 245cm.



Çikirku MSA Workman

Përmban një energji absorbuese të brendshme dhe ofron hyrje të sigurtë kur nuk është e mundur të bëhet hyrja në mënyra të tjera. Mbështetësja e integruar lehtë mund të montohet në tripod. Sistemi i dyfishtë i frenimit ofron mbrojtje sekondare. Përveç kësaj, mund të transportohen ngarkesa deri në 225kg.

Shpëtuesja MSA Workman

Ndaluesja e rënies e duhur me ngritje shpëtimi të integruar dhe mbërthyes e bën lidhjen me tripod një sistem sigurie të thjeshtë dhe fleksibil. Kjo pajisje me një kablo 1.5m të gjatë mund të përdoret për detyra të tjera pa tripod, si në shtylla çeliku ose pika ankorimi.

Rripat

Këta rripa të lehtë dhe të qëndrueshëm ofrojnë rehati të plotë për përdoruesin. Treguesi i ngarkesës së integruar ndihmon kontrollimin e shpejtë nga përdoruesi para përdorimit. Llojet e rripave me nyje mundësojnë operacionet e shpëtimit përmes hapsirave të ngushta. Të certifikuar sipas EN 361, EN 1497 (varësisht prej modelit).



Shufër zgjeruese

Kur është e lidhur me nyjet e rripit V-FORM, kjo pajisje mund të përdoret për të shpëtuar njerëzit nga hapsirat e ngushta. Nyjet e bashkangjitura mund të përdoren për të siguruar viktimat me krah të lënduar gjatë tërheqjes ose uljes. E certifikuar sipas EN 354.



Litarët vetë-tërheqës

Latchways SRL Standard

Pajisje plotësisht rezistuese në terren me forcë konstante dhe mekanizëm frenimi 100% Full Contact, gjendet në lloje të ndryshme të gjatësive me litarë të trashë të thurur dhe kablo. Pajisjet Latchways SRL janë të përshtatshme për përdorim në atmosfera shpërthyes. E certifikuar sipas EN 360.



V-TEC 6m SRL

Kjo pajisje me elemente shtesë dhe projektim inovativ ofron tërheqje të kontrolluar të kabllit që parandalon shpejtësinë e tepërt dhe mbrojtjen e pjesëve të brendshme nga dëmtimi. Çengeli rrotullues shmang përdredhjen e kabllit gjatë përdorimit. E certifikuar sipas EN 360.



Litari

Litarët e MSA-së mbrojnë punëtorin në puseta. Duke përdorur litarët e gjatësisë së përshtatshme me amortizues të integruar, është e mundur që shumë shpejtë të sigurohen personat drejtpërdrejtë në afërsi të pusetës. Të certifikuar sipas EN 354, EN 355.



Automjeti për mbrojtje nga lartësitë

Automjeti trajnuar për mbrojtje nga lartësitë është i dizajnuar për të demonstruar llojet e shumta të produkteve tona, nga rripat deri te litarët, sistemet e projektuara horizontale dhe vertikale si dhe industrinë tonë të pajisjeve vetë-tërheqëse. Kontaktoni përfaqësuesin tuaj të MSA-së për të përfituar nga një demonstrim.





Helmetë e Lehtë Industriale për Hapsira të Ngushta

Helmeta V-Gard 520 është e lehtë dhe e rehatshme me vizorë të shkurtë dhe strehë. Kapësja për kokë FasTrac III me rregullatorë, shiriti shtesë dhe rripi elastik i qafës mundëson që helmata të jetë stabile edhe nëse përdoruesi përkulet. Janë në dispozicion një sërë opsionesh të certifikuara, të tilla si shiritat për mjekër, mbajtëse për llambë, ngjitëse reflektuese, ngjyra të ndezura, logo e shtypur, vizorët, mbrojtja e dëgjimit, shtrojë për dimër dhe ventilues.

Gjithashtu janë në dispozicion edhe modele të tjera të helmatave me sistem ventilimi si dhe shumë opsione të tjera. Ju lutemi kërkoni broshuren e plotë të sistemit V-Gard 06-104.2.

Mbrojtja e ndëgjimit

Kufjet left/RIGHT janë të dizajnuara që të përshtaten për çdo formë dhe madhësi të veshëve të cilat ofrojnë mbrojtje dhe rehati të lartë. Dizajni i shkëlqyeshëm i mbajtëseve të kufjeve përshtatet për kokë në mënyrë që të jenë të rehatshme dhe stabile si dhe të mund të përshtaten për këndin e veshëve.

Përshtatja precize ofron mbrojtje maksimale nga zhurmat e larta duke përdorur kufje sa më të vogla. Shiriti ose mbajtësja e kufjeve rregullohet ashtu që të përshtatet për madhësi të ndryshme të kokës.

Këto kufje janë të gatshme në zbutje të ulët, të mesme dhe të lartë të zhurmës, në tri madhësi dhe ngjyra të ndryshme. Ngjyra e verdhë është ideale për punën nëpër ambiente me ndriçim të ulët.



Pajisjet SCBA Afatshkurtër, me kombinim dhe ato të shpëtimit

Pajisjet PremAire ofrojnë ajër të mjaftueshëm për frymëmarrje për rreth 15 minuta për kontrolle të shkurtra, inspektime ose, në rast emergjence, për të dal ose për të larguar kolegun jashtë zonës së rrezikut. Kjo pajisje është ideale për të punuar pavarësisht ajrit të ambientit në të gjitha përdorimet me distanca të shkurtra, ku SCBA afatshkurtë aplikohet. Për aplikimet që kërkojnë një burim të zgjeruar të ajrit të kompresuar, MSA-ja ofron sistemin MASS Trolley. Ky sistem i siguron përdoruesit një burim të lëvizshëm të ajrit kudo që të jetë e nevojshme. Mund të porositet në disa forma në mënyrë që të përmbushë kërkesat unike për të punuar në situata të rrezikshme.



Kombinim PremAire



PremAire për largim



MASS Trolley

Detektor Portativ për Shumë Gazëra



Bluetooth tani si një veçori standarde

- Shikoni informata në ekranin e telefonit tuaj të mençur Android: të dhënat e menjëherëshme të ALTAIR 4XR / ALTAIR 5X, informata mbi gjendjen e sensorit, alarme të ndryshme duke përfshirë lajmërimet për gaze dhe lëvizje
- Konfiguroni ALTAIR 4XR /ALTAIR 5X nga larg me telefonin tuaj të mençur Android
- Dërgoni SMS të automatizuara me vendndodhje GPS te një marrës i vetëm ose te shumë të tillë: alarme të gazit, alarme të lëndimit, data të kalibrimit dhe ndalim të alarmeve
- Opsioni i testimit kalkulon kohëzgjatjen e marrjes së mostrave



ALTAIR 5X

ALTAIR 5X

Detektori ALTAIR 5X me pompën e integruar dhe opsionin PID është i dizajnuar veçanërisht për hyrje në hapsira të ngushta në ambiente me ujëra të ndotur. Me më shumë se 20 sensorë të gatshëm, ajo matë deri në 6 gaze. Matjet e hapsirës mund të bëhen me telin testues dhe sondën lundruese.



Gazet e rrezikshme si Metani, O₂, CO, H₂S dhe CO₂ janë të monitoruara vazhdimisht dhe matjet ruhen në kujtesën e pajisjes. Sensorët e integruar XCell ofrojnë përgjigje të shpejtë që ndihmojnë në shpëtimin e jetëve. ALTAIR 5X përballon një rënie prej 3 m dhe vjen me ngjyrë standarde të zezë ose fluoeshente, e përkryer për aplikime me shikueshmëri të ulët

Për siguri të shtuar, ALTAIR 5X ofron ekskluzivisht alarmin për lëndime MotionAlert dhe alarmin manual InstantAlert.

ALTAIR 4XR

E vlerësuar IP68 dhe e dizajnuar që të përballojë rënie deri në 75 m lartësi, ALTAIR 4X është opsioni i përkryer për punëtorët e industrisë së trajtimit të ujërave të ndotur. Është e pajisur me sensorët XCell që japin përgjigje të shpejtë dhe që janë 2 herë më të shpejtë se sa mesatarja e industrisë - që do të thotë që punëtorët njoftohen për ambientet e rrezikshme më herët — që përfundimisht shpëtojnë jetë. ALTAIR 4XR, i cili është i aprovuar nga ATEX Zone 0, i kalon standardet e industrisë në fusha të tjera shumë të rëndësishme: operon për 24 orë dhe ofron alarmin e lëndimit MotionAlert dhe manual InstantAlert. Të gjitha këto përfshihen në një garancion 4- vjeçar.



ALTAIR 4XR



Aksesorët Testues

Ofrohen të gjitha llojet e aksesorëve testues, siq janë telat testues të gjatësive të ndryshme, sonda lundruese dhe sonda testuese. Sonda me Pompë ALTAIR është një aksesorë shumë i qëndrueshëm dhe me shumë përdorime, e aftë që të marrë mostra prej deri 30 m larg, shumë lehtë mund ta ktheni ALTAIR 4XR/ 4X në një detektorë me pompë për përdorim në hapsira të ngushta



Sonda me Pompë ALTAIR



Sonda Testuese



Teli Testues me Sondë Lundruese



Mbajtësja Automatike Testuese GALAXY GX2



Testimi Manual me Gaz Testues

Testimi dhe Kalibrimi

Për testimin e funksionalitetit dhe/ose nevojat e kalibrimit, mund të zgjedhni Mbajtësen Automatike Testuese GALAXY GX2 ose testimin manual duke përdorur një zvogëlues të shtypjes

Informata rreth porosisë

Mbrojtje nga Rënia	
10116521	Tripod MSA Workman
10158192	Ndalues i rënies MSA Workman, 15 m
10147567	Çikirku MSA Workman, 15 m
10129888	Karabiner Çeliku
10169369	Çantë mbajtëse për tripodin MSA Workman
506222	Rrotull
10180196	Set rripash V-FORM
10115550	Shufër zgjeruese MSA Workman
62215-00UK	SRL Standard Latchways, 15 m, Kabllo çeliku
63306-00AEU	SRL V-TEC 6m, Kabllo çeliku
10115731	Rripi MSA Workman me absorbues energjie
Mbrojtje të kokës	
GVD1A-00002G0-000	V-Gard 930, pa ajrosje, e bardhë, mbërthyesë metali e përparme për llampë, ngjitës të argjendtë
GV969-6000840	Helmetë V-Gard 520 portokalli, Fas-Trac III Premium, shirit mjekrre me 4 pika, mbërthyesë metali e përparme për llampë, ngjitës i verdhë reflektiv i lakuar,
Mbrojtje të dëgjimit	
10087425	Kufje left/RIGHT, rrip koke, e verdhë, zbutje mesatare
10087428	Kufje left/RIGHT, të montuara në helmetë, e verdhë, zbutje mesatare

SCBA Afat-Shkurtër, Kombinim & Pajisje Largimi	
10152572	Kombinim PremAire Mini, me maskë për tërë fytyrën 3S, cilindër kompozit 3l (i zbrazët)
10152778	Kombinim PremAire për Linjë Ajrore/SCBA, me maskë për tërë fytyrën 3S, cilindër kompozit 2l (i mbushur)
10152728	Kombinim PremAire për Largim, me maskë për tërë fytyrën 3S, cilindër kompozit 2l (i mbushur)
10152752	PremAire për Largim, me maskë për tërë fytyrën 3S, cilindër kompozit 2l (i mbushur)
Sistemet e Karrocave	
M0018642	Sistemi i MASS Trolley, me tub 40 m, pa cilindër
Detektorë të Gazit Portativ & Aksesorë	
10119614	ALTAIR 5X Wireless LEL, O2, CO, H2S
10166730	ALTAIR 5X Wireless LEL, O2, CO, H2S, PID
10082307	Tel testues 5 m me sondë lundruese
10178573	ALTAIR 4XR LEL, O2, CO, H2S
10178569	ALTAIR 4XR LEL, O2, CO, H2S Fosforoshente
10152668	Pompë Sondë ALTAIR

Nëse keni pyetje në lidhje me aplikimet në trajtimin e ujërave të ndotura, ju lutem kontaktoni partnerin tone lokal ose na dërgoni email neve në Water.UK@MSAsafety.com

Shërbimet e MSA

Përveç llojeve të ndryshme të pajisjeve të mbrojtjes personale të cilësisë së lartë dhe sistemeve të detektimit të gazit, MSA ofron edhe një shkallë të lartë të zgjidhjeve të personalizuar për shërbime. Llojet e shumëta të shërbimeve që i ofron MSA sigurojnë që pajisjet dhe sistemet tuaja do të jenë gjithmonë të besueshme, ekonomike dhe gati për përdorim. MSA është gjithmonë në shërbimin tuaj në mënyrë që të ju ofrojë mbështetjen që ju nevojitet, kur ju nevojitet.

Ju lutem na vizitoni gjithashtu tek MSAsafety.com që të merrni më shumë informata rreth produkteve, fotografi, video, dokumente që mund ti shkarkoni dhe vegla të tjera, siq janë simulimet dhe konfigurimet. Sigurohuni që të abonoheni në MSA eNews dhe lidhuni me ne në LinkedIn për lajmet më të reja mbi MSA, gjithashtu abonohuni në kanal tonë në YouTube për informata mbi video të reja.



Your direct contact

Adresa: Kompleksi Industrial TEKNIKU
Fsh.Lug Bunar, 50000 Gjakove
NRB: 70119037
NRF: 600094932
Tel. 0390 326 497
Mob. 044 122 927, 044 129 214
e-mail: info@tekniku.net; tekniku@yahoo.com
http: www.tekniku.net

Great Britain
Hopton Park, Devizes
Wiltshire, SN10 2JP
United Kingdom
Phone +44 (0)800 066 2222
info.gb@MSAsafety.com